QKB

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE**

**DEGA TIRANE**

**Nr.** 6171 **Rep.**

**Nr.** 2358 **Kol.**

**KONTRATE**

**DHURIMI KUOTASH**

Ne Tirane, sot me date 16 .12.2019, perpara meje noteres Mimoza I. Sadushaj, anetare e Dhomes Kombetare te Notereve, Dega Tirane, me adrese Rruga "Vaso Pasha", pall.13/1, u paraqiten personalisht palet:

1. **Znj. MERITA HYSI**, e bija e Xhevatit, lindur më 20.07.1978 në Elbasan, dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me Nr. 030504947 dhe Nr. Personal H85720005C (Dhuruesi);

**- DHE –**

2. **Z. MADALIN – IONEL APOSTU**, i biri i Coctika, lindur më 20.09.1984 në Focsani, Rumani dhe banues në Vrancea, Rumani, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportë rumune me Nr. 056395991 (**Përfituesi**);

Të cilët, bazuar në nenet 761 e vijues të Kodit Civil dhe ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë ranë dakord si më poshtë:

**KUSHTE PARAPRAKE:**

1. Dhuruesi dhe përfituesi në bazë të Ekstraktit të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, janë ortakë të shoqërisë "ALBAPORTE INDUSTRY"SHPK, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 15.10.2018, me Nipt L82215031S. Konkretisht dhuruesja Merita Hysi është ortake me 1 pjesë e cila përbën 12.50% të kapitalit të shoqërisë, ndërsa përfituesi MADALIN – IONEL APOSTU është ortak me 1 pjesë e cila përbën 25% të kapitalit të shoqërisë. Kapitali i shoqërisë është 10.000 euro, dhe është i ndarë në 4 kuota.

2. Sipas rezultatit të kërkimit të leshuar nga Regjistri i Barrëve Siguruese, për palën dhuruese, nuk ka asnjë barrë të regjistruar.

**Neni 1**

**Objekti**

Kjo kontratë ka për objekt dhurimin pa shpërblim të pjesës që Znj. Merita Hysi zotëron, pjesë e cila përben 12,5% të kapitalit të shoqërise, "AlbaPorte Industry" sh.p.k. me NIPT L82215031S në favor të Madalin – Ionel Apostu, në cilësinë e përfituesit.

**Neni 2**

**Të drejtat dhe detyrimet e dhuruesit**

1. Dhuruesi deklaron se është pronar i vetëm mbi 12,5% të kuotave të shoqërisë "AlbaPorte Industry" sh.p.k.
2. Dhuruesi pranon që me nënshkrimin e kesaj kontratë heq dorë nga kuotat në shoqërinë "AlbaPorte Industry" sh.p.k., si dhe cdo e drejtë pasurore dhe detyrim që buron nga to, në favor të përfituesit.
3. Dhuruesi garanton përfituesin se mbi kuotat e dhuruara nuk ekziston asnjë pretendim pronësie nga palë të treta dhe nuk rëndon asnjë e metë, e tillë që mund të pengonte gëzimin e plotë dhe të qetë të pronësisë së tyre nga ana e përfituesit.
4. Për kalimin e pronësisë së kuotave nga pala dhuruese tek përfituesi jep pëlqimin edhe bashkëshorti i palës dhuruese, Z. Artan Hysi, i biri i Hajrullait, lindur me 07.10.1970, në Korçe dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr. 030504972 dhe Nr. Personal H01007031E.

**Neni 3**

**Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit**

1. Përfituesi deklaron se pranon dhurimin e bërë nga dhuruesi dhe merr në pronësi të tij 12,5% të kuotave të shoqërisë "AlbaPorte Industry" sh.p.k. që i përkisnin dhuruesit.
2. Përfituesi pranon që me nënshkrimin e kësaj kontrate merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kuotat që zotëronte në shoqëri dhuruesja.
3. Përfituesi garanton dhuruesin se me kalimin në pronësi të kuotave të shoqërisë "AlbaPorte Industry" sh.p.k., pavarësisht nëse shoqëria rezulton me fitim ose humbje për

vitin 2019, dhuruesi nuk do të ketë asnjë të drejtë apo detyrim ndaj shoqërisë, si dhe ndaj cdo institucioni publik apo privat.

**Neni 6**

**Efekte ligjore**

Pas realizimit të këtij transferimi, me nënshkrimin e kësaj kontrate :

1. Z. **MADALIN – IONEL APOSTU** , bëhet ortak i shoqërise me 37.50% te kapitalit të shoqërsë .
2. **Znj. MERITA HYSI**, largohet si ortake e shoqërisë.

**Neni 7**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo lloj mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontrate u hartua ne 4 (kater) kopje me vlera të njejta juridike, dhe ju lexua palëve, më prani të përkthyeses Xhiljola Alinj, ne bazë të ligjit nr. 110/2018, date 20.12.2018 "Për Noterinë", të cilët deklaruan se e kuptuan aktin e mësipërm dhe se janë dakort me sa më sipër, dhe e nënshkruan rregullisht përpara meje dhe unë noterja, e vërtetoj atë sipas ligjit.

**PALA DHURUESE**

**MERITA HYSI**

**Jep pelqimin bashkeshorti :**

**ARTAN HYSI**

**PALA PERFITUESE**

**MADALIN – IONEL APOSTU**

**NOTERE**

**MIMOZA I. SADUSHAJ**

# VENDIM

## I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

**Nr. 2, datë 16.12.2019**

Sot, më datë 16.12.2019, u mblodhën në selinë e shoqërisë "ALBAPORTE INDUSTRY" sh.p.k., me NIPT L82215031S, ortakët e saj, përkatësisht:

1. **Z. Shpëtim SHIJAKU**, shtetas Shqiptar, lindur më 01.05.1962, banues në Fushe Kruje, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 0244433891, me Nr. personal G20501079L, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar;

2. **Z. Mădălin-Ionel APOSTU,** shtetas Rumun, lindur me 20.09.1984, banues në Vrancea, Rumani, mbajtes i pasaportes me Nr. 056395991, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar;

3. **Z. Raffaele ALBERTORUSSI**, shtetas Italian, lindur me 20.10.1958, banues në Francavilla al Mare, Itali, mbajtes i pasaportes me Nr. YA2740855, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar;

4. **Znj. Merita HYSI**, e bija e Xhevatit, lindur më 20.07.1978 në Elbasan, dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me Nr. 030504947 dhe Nr. Personal H85720005C;

Duke qenë se plotësohet kuorumi i nevojshëm, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme për rendin e ditës:

(i) Kalimi i kuotave prej 12,5% që Znj. Merita Hysi zotëron pranë shoqërisë "ALBAPORTE INDUSTRY" sh.p.k. në favor të Z. Madalin – Ionel Apostu.

Në përfundim të diskutimeve në lidhje me çështjen e rendit të ditës të lartpërmendur, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me unanimitet,

**VENDOSI**:

1. Pranimin e kalimit të kuotave prej 12,5% që Znj. Merita Hysi zotëron pranë shoqërisë "ALBAPORTE INDUSTRY" sh.p.k. në pronësi të Z. Madalin – Ionel Apostu.
2. Pranimin e largimit të ortakes Znj. Merita Hysi nga shoqëria "ALBAPORTE INDUSTRY" sh.p.k., si rezultat i kalimit të kuotave të saj në pronësi të Z. Madalin – Ionel Apostu.
3. Të njohë Z. Madalin – Ionel Apostu, si ortak me 37,5% të kuotave në shoqërinë "ALBAPORTE INDUSTRY" sh.p.k.
4. Autorizohet Administratori i shoqërisë, Z. Petrit Stafuka apo një person tjetër i autorizuar prej tij për depozitimin e këtij Vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe reflektimin e ndryshimeve në ekstraktin tregtar të shoqërisë, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Meqënëse nuk kishte çështje të tjera për t'u diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme u deklarua e mbyllur.

**ORTAKËT**

**Shpëtim SHIJAKU**

**Madalin – Ionel APOSTU**

**Raffaele ALBERTORUSSI**

**Merita HYSI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Sh. p. k.
ALBAPORTE INDUSTRY
NUIS: L82215031S
it - al
TIRANË - ALBANIA

# Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-2019121695538961 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 16.12.2019 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 9:55:38AM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-219-631 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

MERITA XHEVAT HYSI
ALBAPORTE INDUSTRY SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE - ALBANIA

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## FATURË

| | |
|---|---|
| **Emri i Perdoruesit:** | MIMOZA<br>ISLAM<br>SADUSHAJ |
| **Adresa:** | RR: VASO PASHA, P. 13/1<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI |

| | |
|---|---|
| **Nr. i Llogarise:** | 400-219 |
| **Date:** | 16.12.2019 |
| **Pershkrimi:** | D-2019121695538961 |
| **Balanca Perpara:** | Leke 2,000.00 |
| **Debi** | Leke 1,900.00 |
| **Balanca Aktuale:** | Leke 100.00 |
| **Komente:** | Pagese kerkim regjistrimi |

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L82215031S | |
| 2. Data e Regjistrimit | 15/10/2018 | |
| 3. Emri i Subjektit | ALBAPORTE INDUSTRY | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 10/10/2018 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 10/10/2018 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Preze AHMETAQ Njesia Administrative Preze, Preze Ahmetaq, Zona Kadastrale 1006, Pasuria Nr.94/35 | |
| 8. Kapitali | 10.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 4,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te konsistoj ne te gjitha llojet e aktiviteteve sipas klasifikimit kombetar te aktiviteteve, pervec atyre aktiviteteve per te cilat kerkohet miratimi ose akti i nje organi shteteror ose organi te autorizuar.Fusha kryesore e aktivitetit do te jete:Prodhimi dhe tregtimi i dyerve dhe portave, te jashtme dhe te brendshme, si dhe materialeve te tjera te mobiljerise te lidhura per montimin dhe funksionin e llojeve te ndryshme te dyerve. | |
| 10. Administratori/ët | Petrit Stafuka | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 10/10/2019 | Deri: 10/10/2024 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | Raffaele AlbertoRussi | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 1.250,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |

| | | |
|---|---|---|
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 12,50 | |
| - *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 13. Ortakët | MeritaHysi | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 1.250,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 12,50 | |
| - *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 14. Ortakët | ShpëtimShijaku | |
| 14.1 Vlera e kapitalit | Para: 5.000,00 | Natyre: |
| 14.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 50,00 | |
| - *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 15. Ortakët | Madalin-IonelApostu | |
| 15.1 Vlera e kapitalit | Para: 2.500,00 | Natyre: |
| 15.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 25,00 | |
| - *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Durres Fushe Kruje ARRAMERAS Arrameras, Autostrada Tirane-Shkoder, Km 17, Zona Kadastrale 1042, Nr Pasurie 58 | |
| 17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: ALBAPORTE INDUSTRY<br>E-Mail: tirana@rokas.com<br>Telefon: 0689088455<br>Të Tjera: Kapitali i shoqerise eshte ne Euro. | |
| 18. Statusi: | Aktiv | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Datë: 16/12/2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**
**ZYRA E PERMBARIMIT GJYQESOR PRIVAT ROLAND NANO**
**Rr. Muhamet Gjollesha, Godina Toena, kati 3, nr 32, Tirane. Nr.tel 0672025385**

Nr.537 Prot. Tiranë, më 13.12.2019

**URDHËR**
**PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE MBI KUOTAT E SHOQERISE**

**Drejtuar: Qendres Kombetare te Biznesit**

Unë Roland B Nano, përmbarues gjyqësor privat bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr. 6075 date 07.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tirane.

**KONSTATOVA:**

Se më datë 24.05.2017, është depozituar pranë zyres përmbarimore kërkesa e kreditorit Raiffeisen Bank sha, së bashku me "Urdhërin e Ekzekutimit" të Kontrates se Kredise Bankare me Nr.1564Rep Nr 1264Kol date 08.08.2013 me palë :

- **Kreditor : Raiffeisen Bank sha**
- **Debitor : Shoqeria "Ines Company" shpk NIPT K91923013K dorezanes Artan Hysi, Merita Hysi**
- **Objekti : Kthim Kredie**

Ne kushte kur pala kreditore me kerkesen e saj Nr 37416 Prot date 12.12.2019 drejtuar zyres permbarimore kerkon pushimin e ekzekutimit te urdherit te ekzekutimit dhe heqjen e sekuestrove konservative meqenese pala debitore, dorezanese kane shlyer ne total detyrimin e kredise.

**URDHËROJ**

**1**-Heqjen e masës së sekuestros konservative mbi 100 % te kuotave qe zoteron perkatesisht **Artan Hysi** ne **Shoqeria "Ines Company" shpk NIPT K91923013K si dhe** dorezanesja Merita Xhevat Hysi, dtl 20.07.1978, ortake ne **Shoqerine"ALBAPORTE INDUSTRY" shpk NIPT L82215031S**, me seli ne Preze Tirane, **Shoqeria "INES COMPANY" DYER ITALIANE SHPK L61429016B** me kerkese te pales kreditore.

**2**-Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

**3**-Personat që bëhen pengesë, do të pergjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim te K.Pr.Civile

**4**-Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5(pese) ditëve nga marrja dijeni.

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**Roland NANO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

ZYRA E PERMBARIMIT GJYQESOR PRIVAT ROLAND NANO

**Adresa: Rruga"Muhamet Gjollesha " Godina Toena, kati 3, nr 32 Tirane Nr.tel 0672025385**

**Nr.537 Regj.** **Tirane. më 13/12/ 2019**

# VENDIM

## Pushimi te "Urdherit te Ekzekutimit" me kerkese te kreditorit

Unë përmbaruesi gjyqësor privat Roland Nano, pasi studiova materialet e dosjes permbarimore me Nr 537 në zbatim te Urdhrit te Ekzekutimit Nr. 6075 date 07.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tirane.

## KONSTATOVA:

Se më datë 16.02.2018, eshte depozituar prane zyres permbarimore kerkesa e kreditorit së bashku me "Urdhrat e Ekzekutimit" të kontrates se kredise bankare Nr 1556Rep Nr 1006Kol date 29.04.2013 me palë dhe objekt:

**Kreditor : Raiffeisen Bank sha**

**Debitor : Shoqeria "Ines Company shpk NIPT K91923013K dorezanes Artan Hysi, Merita Hysi**

**Me objekt : Kthim kredie**

## KONSTATOJ

Në titullin ekzekutiv kontrate se kredise Nr 1564 Nr 1264Rep datë 05.08.2013 është vendosur detyrimi ne shumen prej 65,052.48Eur. Për titullin ekzekutiv nga Gj.Rr.Gj Tirane është lëshuar vendimi i Urdhrit të ekzekutimit nr.6075date 07.10.2016. Pala kreditore me kerkesen e saj Nr 37416 date 12.12.2019 i eshte drejtuar zyres se permbarimit ku kerkon pushimin e veprimeve permbarimore dhe heqjen e sekuestros nga llogarite e debitorit, dorezanesve meqenese kane shlyer ne total detyrimin e kredise+ tarifen permbarimore

Sa me siper ne mbeshtetje te nenit 616/b te K.Pr.Civile dhe ligjit Nr 10031date 11.12.2008 "Per Sherbimin Permbarimor Gjyqesor Privat"

## VENDOSA

Pushimin e "Urdherit te Ekzekutimit" nr.6075 date 07.10.2016 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane, me kerkese te kreditorit.

Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5(pese) ditëve nga marrja djeni

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**Roland NANO**